



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1434/7 prot.

Datë 03.08.2023

V E N D I M
Nr. 724/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.08.2023, shqyrtoi kërkesën me:

- Objekt:** Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës me numër.1434 prot., datë 22.06.2023 për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF – 70983-05-30-2023 me objekt: “*Mbikëqyrje punimesh me objekt, Rikonstruksion i shkollës + ndërtim palestre, Mjedë*”, me fond limit 1.443.718 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia “Vau Dejës”.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Miki Consulting” SHPK
Lagjja “Vasil Shanto”, Rruga “Vaso Kadia”, godina nr. 1/506, Shkodër
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia “Vau Dejës”
Rruga “Qafa e Gurit”, Vau Dejës
- Subjekte të Interesuara:** “Engineering Consulting Group” SHPK
Rruga “Arkitekt Kasemi”, pallati nr.22, te Brryli, Tiranë
- Baza Ligjore:** Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.500/2020, datë 05.11.2020 “Rregullore për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 31.05.2023 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF – 70983-05-30-2023 me objekt: “Mbikëqyrje punimesh me objekt, Rikonstruksion i shkollës + ndërtim palestre, Mjedë”, me fond limit 1.443.718 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia “Vau Dejës”.

II.2. Në datën 12.06.2023, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 20.06.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

Engineering Consulting Group ShPK	1.269.688,00	Kualifikuar
Miki Consulting ShPK	1.269.688,60	Kualifikuar
Hydro-Eng Consulting ShPK	1.269.689,00	Kualifikuar
Project Daluz 2019 Shpk & M.A.K Studio ShPK	1.322.925,00	Kualifikuar
Boe Bersant Ylli Person Fizik & Magna Charta ShPK	1.269.688	Skualifikuar

II.4. Në datën 22.06.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE, Njoftimin e Fituesit Paraparak për procedurën e prokurimit.

II.5. Në datën 22.06.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3200, si dhe nr. protokollit 1434/2023 datë 22.06.2023 i operatorit ekonomik “Miki Consulting” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF – 70983-05-30-2023 me objekt: “*Mbikëqyrje punimesh me objekt, Rikonstruksion i shkollës + ndërtim palestere, Mjedë*” me fond limit 1.443.718 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia “Vau Dejës”.

Nga shqyrtimi paraparak i ankesës të sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Engineering Consulting Group” SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimesit.

II.7. Me shkresën nr. 3993 prot, datë 30.06.2023 me objekt: “Njoftim”, protokolluar me tonën me nr. 1434/3 prot datë 05.07.2023, autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacionin për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, ku citohet se autoriteti nuk e ka trajtuar ankesën me argumentin se: “*Ju nuk keni paraqitur ankesë pranë Bashkisë Vau i Dejës as fizikisht as elektronikisht*”.

II.8. Për shkak të specifikës së kësaj procedure prokurimi, Komisioni i Prokurimit Publik për gjykimin sa më të drejtë të ankesës së operatorit ekonomik ankimes, me vendimin e ndërmjetëm 696/2023 datë 31.07.2023, vendosi të thërrasë ekspertin e fushës, për të verifikuar nëse

përlllogaritja e fondit limit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi është bërë konform bazës ligjore të përcaktuar, e më konkretisht Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.354 datë 11.05.2016, “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

II.9.Vendimi i ndërmjetëm i KPP-së nr. 696/2023 datë 31.07.2023 iu komunikua operatorit ekonomik ankimues “Miki Consulting” SHPK, me qëllim bërjen e pagesës për kryerjen e akt ekspertimit nga eksperti i fushës.

II.10. Në datën 03.08.2023, operatori ekonomik ankimues “Miki Consulting” SHPK, ka ngarkuar në sistemin elektronik të ankesave shkresën Nr.0703 prot. datë 03.08.2023, protokolluar me tonën me nr.1434/6 prot., datë 03.08.2023, me objekt “Dërgim vendimi për tërheqje nga ankimimi Nr. A/2023/3200, date 22.06.2023 për procedurën e prokurimit me Nr. REF-70983-05-30-2023 me AK Bashkia Vau Dejës”, duke u shprehur se:

“ [...]”

Bazuar në çka cituam me sipër dhe në përgjithësi në kuptim të vendimit Nr. 696/2023 të KPP, vlerësojmë se:

1. Ankesa është bërë në KPP dhe bazuar në ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar si dhe VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për Miratimin e Manualit të Tarifave për Shërbime në Planifikimin e Territorit, Projektimit, Mbikëqyrjes, dhe Kolaudimit” dhe shtojcës 1 pjesë e këtij vendimi e cila përcakton metodikën e llogaritjes së tarifës maksimale dhe minimale.

2. Në ankesën që është bërë nga OE “Miki Consulting” ShPK është shënuar opsioni “që nuk kërkojmë ekspertë” dhe për këtë arsye nuk e vlerësojmë të drejtë që të paguajmë ekstra një shumë të konsiderueshme për ne.

3. Nisur nga ky vendim i KPP dhe vlerësimet tona të mësipërme, OE “Miki Consulting” ShPK ka vendosur tërheqjen nga ankimimi Nr. A/2023/3200, date 22.06.2023 për procedurën e prokurimit me Nr. REF-70983-05-30-2023 me AK Bashkia Vau Dejës”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues “Miki Consulting” SHPK për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF – 70983-05-30-2023 me objekt: “Mbikëqyrje punimesh me objekt, Rikonstruktion i

shkollës + ndërtim palestre, Mjedë”, me fond limit 1.443.718 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia “Vau Dejës”,
Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet:

“1. Ankimuesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimuesit nuk i kthehet tarifa e ankesës.

2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”

III.1.2. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimin e tij. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik ankimues për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës me numër 1434 prot., për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF – 70983-05-30-2023 me objekt: “*Mbikëqyrje punimesh me objekt, Rikonstruktion i shkollës + ndërtim palestre, Mjedë*”, me fond limit 1.443.718 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia “Vau Dejës”.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare së paguar nga operatori ekonomik “Miki Consulting” SHPK.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

